



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 537/ 2 prot

Datë 05.03.2024

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME PRETENDIMET MBI KUALIFIKIMIN E OFERTUESVE TË TJERË

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “MC Netëorking” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me objekt “Shërbim Netëorku për Trasmetimin e të Dhënave midis Zyrës Qendrore dhe Zyrove në Rrethe” me Nr. REF-93325-01-17-2024, me fond limit 19,366,000 (nëntëmbëdhjetë milion e treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07.02.2024 nga autoriteti kontraktor IdentiTek SH.A
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Communication Progress” SHPK, me NIPT K01625001C, adresa: rruga “Stanislav Zuber” SHPK, Nd. 2, H.19, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** IdentiTek SH.A
Adresa: Rruga “Xhanfize Keko”, Ish Topografia Ushtarake, Tiranë.
- Subjekte të interesuar:** Operatori ekonomik “MC Netëorking” SHPK me NIPT K72223007O, me adresë: rruga “Pjetër Bogdani”, Godina nr. 3, Tiranë.

Në datën 04.03.2024 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor është administruar ankesa me numër elektronik A/2024/3857, dhe nr. 537/2024 prot, datë 04.03.2024 e operatorit ekonomik “Communication Progress” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me objekt “Shërbim Netëorku për Trasmetimin e të Dhënave midis Zyrës Qendrore dhe Zyrove në Rrethe” me Nr. REF-93325-01-17-2024, me fond limit 19,366,000 (nëntëmbëdhjetë milion e treqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 07.02.2024 nga autoriteti kontraktor IdentiTek SH.A.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e operatorit ekonomik “MC Netëorking” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërmat “b” dhe “c” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime.”

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë kriteret e kualifikimit për të cilat operatori ekonomik ankimues “Communication Progress” SHPK pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “MC Netëorking” SHPK pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi.

Konkretisht Operatori ekonomik ankimues “Communication Progress” SHPK ngren pretendime se oferta e dorëzuar nga operatori ekonomik “MC Netëorking” SHPK është një ofertë anomalisht e ulët.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 05.03.2024.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj